

Komuna e Zubin Potokut/Zubin Potok

Murtez (Haxhi) Hajra

(1.05.1943, shqiptar nga Rakinica/Rakitnica, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimtarie, dhjetë fëmijë)

Murtezi punonte në Itali. Në datën 10.08.1998 u kthye me autobus në Kosovë. Policia serbe e ka ndaluar autobusin në **Zubin Potok**. Pas kontrollimit të udhëtarëve, policët serb i nxorën dy udhëtarë jashtë autobusit. Murtezi ka bërë pyetje përse u nxorën dy udhëtarë dhe rrjedhimisht edhe atij i urdhëruan që të dilte jashtë autobusit. Murtezi i ka treguar më vonë bashkëshortes se policët i shkopiën që të tre udhëtarë me shkopiinj gome dhe kondakë. Pas një ore, u lejuan që të vazhdonin rrugën. Murtezi u nis për në Skënderaj/Srbica. U ndal te motra për të pushuar ku i biri Avdiu erdhi më vonë dhe

e çoi në shtëpi. Me të mbërritur në shtëpi, ai u alivanos. E kishte një plagë në kokë. Mori vendim që menjëherë të kthehej në Itali për shërim. Sërish u nis me autobus më **10.08.1998**. Policia e ka ndaluar edhe këtë autobus te fshati **Lubavec/Ljubovac**. E kanë rrahur sërish Murtezin. Ka arritur në gjendje të rëndë shëndetësore në Bergamo [Itali], ku jetonte e punonte. Ka kaluar një muaj në spital. Mjekët i kanë thënë se e kishte të dëmtuar damarin dhe se nuk kishin mundësi t'i ndihmonin. I vëllai Zeneli, i cili po ashtu punonte në Itali, e kishte kthyer në shtëpi. Kishin arritur më 9.10.1998. Murtezi ka ndërruar jetë pas dy ditësh, më 11.10.1998. E kanë varrosur po atë ditë në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata I.H, FDH-40676; J. Osmani, *Krimet...*, II, 296.
